

P.nr.2370/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. Th. nga A. P., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.1220-6/2016 të datës 31.10.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare publike, në prezencën e Prokurorit të Shtetit në Prizren Elfete Purova, të akuzuarit, me datë **02.10.2017**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari F. Th., nga i ati H., e ëma H., e vajzërisë E. i lindur më datë në fsh. R., tani me banim në lagjen A. P. në rr. nr., ka të kryer shkollën e fillore, i martuar baba i tre femijeve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me date 18.04.2016, rreth orës 15,10 min, në Prizren, rrezikon trafikun publik duke shkëlur nenin 42 dhe 46, të ligjit për siguri në komunikacion rrugor dhe duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës Opel Astra, me targa të regjistrimit me ngjyre të kaltërt, pa u bindur me parë se mund të bëjë një gjë të tillë duke mos e rrezikuar apo penguar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, e godet me pjesën e përparme të anës së majte, mbrapa në anën e majte automjetin e markës VW Golf me targa , me ngjyre të kaltërt, të cilin e voziste i demtuari P. G. me qrast përpos demëve materiale në automjet, lëndime të lehta trupore peson pasagjerja: B. T. dhe atë ndrydhje të indeve të buta të kokës, lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor dr. F. E. të datës 06.08.2016.

-kësodore ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-së.

Gjykata në bazë të nenit 7, 43, par.1 pika 1.3, 46, 73, 74, 75 e 76 të KPK-se, dhe neni 365 të KPPK-es të akuzuarit i shqipton:

D E N I M M E G J O B E

Ne lartesi prej 150 /njeqindpesedhjetë/ Euro, të cilën shumë të denimit është obliguar që të paguaj në afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmerisë të këtij aktgjykimi, denimi do të paguaj në 3 kiste, nëse denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim i njejtë do të zevendesohet me denim burgimi duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg, respektivisht 7 ditë burgim.



I akuzuari obligohet që ti paguajne shpenzimet e procedurës penale sipas llogarise se gjykates, ne emer te ekspertizes te komunikacionit rrugor shumen prej **40,88 euro**, ne emer te ekspertizes mjeko ligjore shumen prej **20,00 euro**, dhe ne emer te paushallit gjyqesor shumen prej **20,00 euro**, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nen kercnim te ekzekutimit te dhunshem.

I demtuarai P. I. G nga fsh. B. KK Prizren, per realizimin e kerkeses pasuroro juridike, udhezohet ne kontest te rregullt civilo juridik.

Arsyetim

Prokuroria Themelore ne Frizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP.nr.1220-6/2016 të datës 31.10.2016, kunder te akuzuarit F Th nga Prizren, per shkak te vepres penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KP-e

Gjykata ne shqyrtim fillestar ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajsin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se te akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajit per vepren penale e cila iu vihete ne bare, e qe pranimi i fajit eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat i akuzuari ka gene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur ne perfundim se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KP-se, dhe per kete gjykata te akuzuarin i shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobe si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e tyre penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tije, e ne kuptim te nenit 74, 75 e 76 gjykata morri parasysh se i akuzuari ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tije ka gene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, ka pranuar fajesin ne menyre vullnetare si edhe ka shprehur keqardhje per shkak te vepres penale, ka pasur sjellje korrekte para gjykates, me te demtuarin e ka gjetur gjuhen e pajtimit e te mirekuptimit, i martuar baba i tre femijeve, i gjendjes se dobet ekonomike, gjer me tani i pa gjykuar, çka nenkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoi denimin me gjobe sepse konsideron se me kete mase sanksionuese do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se tije dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jete i kujdesshem dhe do te permbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 451 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr. 2370/2016 të datës 02.10.2017

Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari



UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgykimi pala e pakena qur ka te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtes, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.